



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 18.12.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS LULJETA MINXHOZI ANËTARE TË KËSHILLIT
MBIKQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, bazuar në nenin 44 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 dhjetor 2018, shqyrtoi propozimin e një grupi deputetësh të depozituar me shkresën nr. prot 3937, datë 17.12.2018 “Për zgjedhjen e tre anëtare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Në seancën dëgjimore, të zhvilluar nga Komisioni për shqyrtimin e propozimit të grupit të deputetëve, ishte e pranishme zonja Luljeta Minxhozi si një nga kandidaturat e propozuara.

Zonja Luljeta Minxhozi ishte pjesë e kandidatëve, të cilët iu përgjigjën thirrjes publike dhe shprehën interesin për të qenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me vendimin e Kuvendit nr. 103, datë 4.10.2018, “Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës Së Shqipërisë.

Ndërsa në seancën dëgjimore të zhvilluar me Komisionin kandidatja e propozuar paraqiti një informacion të plotë për përvojën profesionale të deritanishme dhe kontributin që mendon të sjellë si anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Më tej, ajo informoi Komisionin lidhur me vizionin e saj mbi masat që duhen ndërmarrë për rritjen e efektivitetit të politikës monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, si dhe koordinimin e saj më eficient me politikën fiskale dhe me reformat strukturore në vendin tonë.

Komisioni vlerëson se kandidatura e zonjës Luljeta Minxhozi plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 44, pika 3 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe kriteret e papajtueshmërisë me funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të parashikuara në nenin 46 të këtij ligji. Gjithashtu, Komisioni gjykon se kjo kandidaturë plotëson kriteret e meritës profesionale për ushtrimin e funksionit të propozuar.

Për këto arsye, Komisioni e miratoi, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, propozimin për zgjedhjen e zonjës Luljeta Minxhozi anëtare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe ia paraqet seancës plenare për votim.

KRYETARI

Erjon BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 18.12.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ARTAN HOXHA ANËTAR TË KËSHILLIT MBIKQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, bazuar në nenin 44 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 dhjetor 2018, shqyrtoi propozimin e një grupi deputetësh të depozituar me shkresën nr. prot 3937, datë 17.12.2018 “Për zgjedhjen e tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Në seancën dëgjimore, të zhvilluar nga Komisioni për shqyrtimin e propozimit të grupit të deputetëve, ishte i pranishëm zoti Artan Hoxha si një nga kandidaturat e propozuara.

Zoti Artan Hoxha ishte pjesë e kandidatëve, të cilët iu përgjigjën thirrjes publike dhe shprehën interesin për të qenë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me vendimin e Kuvendit nr. 103, datë 4.10.2018, “Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës Së Shqipërisë.

Në seancën dëgjimore, të zhvilluar nga Komisioni për shqyrtimin e këtij propozimi, Zoti Artan Hoxha paraqiti eksperiencën e tij profesionale si dhe vizionin për detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me fokus të veçantë në ndryshimet ligjore të nevojshme të kuadrit rregullator të këtij institucioni.

Komisioni vlerëson se kandidatura e zotit Artan Hoxha plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 44, pika 3 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe kriteret e papajtueshmërisë me funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të parashikuara në nenin 46 të këtij ligji. Gjithashtu, Komisioni vlerësoi nivelin e lartë profesional të z.

Hoxha eksperiencën e tij si anëtar i Gjykatës së Lartë, kryetar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, titujt akademikë, detyrat e rëndësishme që kryen në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës. Për këto arsye, Komisioni e miratoi, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, propozimin për zgjedhjen e zotit Artan Hoxha anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe ia paraqet seancës plenare për votim.

KRYETARI

Erjon BRAÇE